VENDIM
Nr. 27, datë 31.3.2014

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP MBI VERIFIKIMIN E MATËSVE KUR FUTEN PËR HERË TË PARË NË TREG DHE/OSE KUR VENDOSEN PËR HERË TË PARË NË PËRDORIM; INSPEKTIMIN PERIODIK PËR VERIFIKIMIN E SAKTËSISË SË MATËSVE DHE TË SISTEMIT TË MATJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, KOLAUDIMIN DHE VULOSJEN, SI DHE TË MIRËMBAJTJES SË TYRE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 51, pika 9, të ligjit nr. 9072 datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2014, pasi shqyrtoi draftin e kontratës tip mbi verifikimin e matësve kur futen për herë të parë në treg dhe/ose kur vendosen për herë të parë në përdorim; inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë së matësve dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, kolaudimin dhe vulosjen, si dhe të mirëmbajtjes së tyre,

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën tip mbi verifikimin e matësve kur futen për herë të parë në treg dhe/ose kur vendosen për herë të parë në përdorim; inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë së matësve dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, kolaudimin dhe vulosjen, si dhe të mirëmbajtjes së tyre (bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Të shfuqizojë kontratën tip për shërbimin e kontrollit fillestar dhe periodik të matësve të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 62, datë 22.7.2011 "Për miratimin e kontratës tip për shërbimin e verifikimit dhe kontrollit fillestar dhe periodik të matësve të energjisë elektrike".
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimmarrjen e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti